



Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë Shpallje për vend të lirë pune – kontratë me afat

Pozita:	Specialist i Prokurimit
Organizata/njësia:	FKEE/Njësia Zbatuese e Projektit
Lokacioni:	Prishtinë, Republika e Kosovës
Data e shpalljes së konkursit:	08.06.2023
Data/ora e mbylljes:	23.06.2023, 16:30 (koha lokale)
Lloji dhe kohëzgjatja e kontratës:	Kontratë pune me orar të plotë (40 orë pune në javë) për një periudhë të caktuar kohore (1 vit), me mundësi vazhdimi dhe konvertimi në staf të brendshëm
Periudha provuese:	3 muaj
Marrëdhënia e punës pritet të fillojë:	Dy javë pas nënshkrimit të kontratës së punës

A) Rrethanat organizative

Me miratimin e Ligjit Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë (LEE), Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) është themeluar si entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, në mbështetje të objektivave të politikës për Eficiencë të Energjisë së Republikës së Kosovës, duke promovuar, mbështetur dhe zbatuar masat e eficiencës së energjisë, si dhe duke tërhequr dhe menaxhuar burimet financiare në mënyrë që të financojë dhe zbatojë projekte investimesh në fushën e Eficiencës së Energjisë në një mënyrë të qëndrueshme.

Specialisti i Prokurimit punësohet për një mandat 1 vjeçar me mundësi vazhdimi, duke përfshirë mundësinë e konvertimit si punonjës i brendshëm me kontratë pa afat, varësisht nga nevoja dhe performanca, subjekt i vendimit të FKEE. Specialisti i Prokurimit i raporton tek Udhëheqësi/ja i/e Njesisë Zbatuese të Projektit (NjZP) dhe Udhëheqësi/ja i/e Shërbimeve të përgjithshme.

B) Roli dhe përgjegjësitë kryesore

Objektivat dhe përgjegjësitë kryesore të Specialistit i Prokurimit janë realizimi i aktiviteteve në fushën e prokurimit publik duke realizuar dhe mbështetur FKEE-në në proceset e ndryshme të përgatitjes, publikimit dhe shpalljes së aktiviteteve të prokurimit sipas planit të FKEE, duke qenë pjesë e Njesisë për Zbatimin e Projekteve – NjZP dhe duke dhënë mbështetje direkt tek vetë FKEE, në kontraktimin dhe zbatimin e projekteve me kohë dhe konform legjislacionit në fuqi, manualit të operimit dhe rregulloreve të brendshme të FKEE-së.

C) Detyrat dhe funksionet specifike si dhe rezultatet e pritshme kryesore

Specialisti i Prokurimit është përgjegjës për sa vijon:

- Planifikimin dhe hartimin e planit të prokurimit për të gjitha mallrat, shërbimet, punët dhe shërbimet që autoriteti kontraktues synon t'i realizojë;
- Siguron se të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen në harmoni me legjislacionin në fuqi që rregullon procedurat e prokurimit në Kosovë;
- Pranon kërkesat e aprovuara nga personat e autorizuar për furnizim për mallra duke përfshirë vlerësimet e kostove për çdo vit financiar;
- Merr pjesë në përgatitjen e shpalljeve dhe në publikimet e ftesave në përputhje me ligjin dhe rregulloret mbi prokurimin, duke përfshirë shpalljen dhe menaxhimin e tyre në platformën zyrtare 'e-prokurimi';

- Në bashkëpunim me Udhëheqësin e NjZP organizon procedurat e kuotimit të çmimeve dhe të tenderëve varësisht nga vlera e parashikuar cakton edhe metodën e prokurimit;
- Përcjell mirëvajtjen e evidentimit të ofertat të pranuar;
- Merr pjesë në komisionet e vlerësimit të ofertave atëherë kur caktohet nga Udhëheqësi i NjZP ose menaxhmenti i FKKE-së;
- Është përgjegjës për arkivimin e dokumenteve përkatëse dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Bën përcjelljen e furnizimeve me mallra dhe përkujdeset në realizimin e kontratave sipas kushteve të përcaktuara në kontratë;
- Pranon mallin nga furnizuesit dhe pastaj e dorëzon në depo me dokumentacion përcjellës;
- Kryen punët e përgatitjes dhe plotësimit të fletë porosive për prokurimet e kryera;
- Merr pjesë aktive në përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore dhe analiza e tyre në bazë të planit vjetor për të gjitha punët e prokurimit;
- Kryen edhe detyra tjera që rrjedhin nga natyra dhe rregullat e punës sipas kërkesës së Menaxhmentit dhe kërkesave të NjZP

D) Kualifikimet, përvoja dhe aftësitë gjuhësore

- Të ketë diplomë universitare bachelor, në drejtimin juridik, ekonomik, administrate publike apo ngjashëm.
- Të ketë 4 vite përvojë pune relevante në fushën e prokurimit, prej të cilave se paku 2 në prokurimin publik sipas legjislacionit të Kosovës;
- Të jetë i certifikuar në fushën e prokurimit publik, ndërsa certifikimet shtesë në menaxhimin e projekteve/kontratave paraqet përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme, me theks të veçantë në fushën e prokurimit publik;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi me shkrim dhe verbal në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe njohje e mirë e gjuhës angleze.
- Njohja e rregullave të prokurimit të donatorëve të FKKE dhe përvoja e punës me to konsiderohet përparësi;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës, aftësi për punë nën presion, orare të zgjatura, punë ekipore;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (E-prokurimi, aplikacionet e MS Office, Internet, etj.);
- Gatishmëri për punë ekipore dhe për angazhim në disa detyra njëkohësisht;
- Leje të vozitjes Kategoria B – preferuar
- Dëshmi se nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për një vepër penale për të cilën dënimi maksimal tejkalon gjashtë (6) muaj burgim dhe dënimi nuk është i kushtëzuar; (evidenca nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së vendeve të këtij njoftimi).

E) Shpërblimi – Paga mujore

Sistemi i pagave: Shpërblimi pakos konkurruese në përputhje me Rregulloren e Brendshme për Shpërblimin e Personelit të FKKE (R-OBPSh), e plotësuar dhe ndryshuar.

F) Të dhëna tjera

FKKE nuk është organizatë buxhetore, marrëdhënia e punës themelohet dhe rregullohet sipas Ligjit të Punës. FKKE ruan të drejtën e anulimit të kësaj procedure, për arsye objektive të argumentuara. Për më shumë detaje rreth FKKE: <https://fkee-rks.net/>

1. Përmbajtja e dokumenteve të aplikimit

Dokumentet e aplikimit duhet të përmbajnë së paku:

- 1) Kopja e dokumentit përkatës që dëshmon shtetësinë e Republikës së Kosovës.
- 2) CV-në e hollësishme të Aplikuesit (preferohet në formatin Europass)
- 3) Letrën e motivimit që përfshin synimet e aplikuesit dhe ndërlidhjen e përvojës dhe kualifikimeve të tij/saj me pozitën (jo më shumë se 3 faqe).
- 4) Kopje e noterizuar e diplomës së studimeve themelore universitare relevante (të kryer në Kosovë), ose dëshminë e njohjes së diplomës nga Republika e Kosovës (nëse studimet janë kryer jashtë vendit)
- 5) Dëshmi se kandidati/ja nuk ka qenë i/e dënuar (shiko kushtet e hollësishme në Seksionin D më lart, pika e fundit)
- 6) Kopje e patentë shoferit konsiderohet përparësi

Dokumentet e aplikimit mund të përgatiten në secilën prej tre (3) gjuhëve: shqip, serbisht ose anglisht.

Kopjet e dëshmive tjera relevante që tregon për kualifikimet, përvojën dhe aftësitë gjuhësore të aplikantëve merren parasysh dhe vlerësohen.

2. Dorëzimi i aplikacioneve

Aplikimet, përfshirë të gjitha dokumentet e kërkuara, dorëzohen në info@fkee-rks.net deri më **23 Qershor 2023, ora 16.30, duke përcaktuar saktë emrin e pozitës për të cilën aplikon.**

Aplikacionet që nuk i kanë të gjitha dokumentet e parapara (1-5 më lart) në formën e kërkuar nuk do të merren parasysh nga komisioni vlerësues.